

V E N D I M

Nr. 805, datë 24.12.1998

PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE NGA SHOQËRIA NË ADMINISTRIM “FABIONA”, SH.P.K., TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozim të zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria në administrim “Fabiona”, sh.p.k., deri në fund të muajit qershor 1999, t’u kthejë të përndjekurve politikë, kreditorë të saj, depozitat e grumbulluara.

2. Të ardhurat neto, që do të sigurohen nga shitja e prodhimeve të shoqërisë në administrim “Fabiona” sh.p.k., deri në qershor të vitit 1999, pasi të shlyhen detyrimet ndaj shtetit, nëpërmjet administratorit, të depozitohen në llogarinë për shlyerje të kreditorëve, të çelur posaçërisht pranë Bankës së Kursimeve dhe të përdoren vetëm për pagesën e të përndjekurve politikë, kreditorë të kësaj shoqërie.

3. Administratori i shoqërisë, për shlyerjen e të përndjekurve politikë, kreditorë të kësaj shoqërie, të bashkërendojë punën me Institutin e Integritetit të të Përndjekurve Politikë dhe me shoqërinë në administrim “Fabiona”, sh.p.k.

4. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe me përfundimin e shlyerjes së kreditorëve, administrimi i shoqërisë në administrim “Fabiona”, sh.p.k., konsiderohet i përfunduar. Në këtë rast, ndërmjet shoqërisë në administrimin “Fabiona”, sh.p.k., dhe administratorit hartohet dokumentacioni përkatës i përfundimit të administrimit, të cilit i bashkëlidhet akti i kontrollit.

5. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit, me fillimin e likuidimit të kreditorëve, të zgjidhin përfundimisht pronësinë mbi këtë objekt, në përputhje me kriteret e rregullat e caktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 192 dhe 195, datë 20.3.1998, për shitjen me rezervë apo për riprivatizimin e saj.

6. Ministria e Financave dhe institucionet financiare në varësi të saj të saktësojnë, deri në përfundim të procesit të administrimit, realizimin e detyrimeve të kësaj shoqërie ndaj shtetit, nëpërmjet rikontrollit të balanceve financiare, si dhe të vlerave financiare të investuara shoqëria në administrimin “Fabiona”, sh.p.k.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Ministria e Financave dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko